



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 1131/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Edi Sejdiu kandidat për asamble kuvendit komunal nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të publikimeve të rezultateve përfunditare për anëtarë të kuvendit komunal, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Edi Sejdiu kandidat për kuvendin komunal në Prishtinë nga radhët e subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Edi Sejdiu anëtar për asamble komonale nga subjekti politik PDK dega në Prishtinë, me të cilin ai pretendon se në bazë të rezultateve të publikuara nga KQZ-ja, se në vendvotimin me numër 1901e SH.F. "Naim Frashëri" formularët e KKZ janë 19, ndërsa rezultati i KQZ është 09. Në vendvotimin 1911e në shkollën fillore "Ismail Qemali" në formularin e KKZ janë 25 ndërsa në rezultatet e KQZ janë 12 vota. Po ashtu në qendrën e votimit 1909e në formularët KKZ –së janë 36 vota ndërsa në rezultatin e KQZ janë vetëm 13 vota. Si dhe duke u bazuar edhe në dëshmit e votuesve të tij edhe në vendvotimin 1227e në shkollën fillore "Shkëndija", në qendrën e votimit 1940 shkollën fillore "Ganimete Tërbeshi si dhe në vendvotimin me numër 1923e është bërë gabim gjatë evidentimit të formularëve të KKZ si dhe në rezultatin final të KQZ-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se nga dëshmit e ofruara dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Edi Sejdiu nga komuna e Prishtinës. PZAP-i, vlerësoi si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së,

si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**

Anr. 1131/2013 më datën 06.12.2013



**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**

***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetkatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.